



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 524 /7 prot.

Datë 18.03.2025

V E N D I M

Nr. 377/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.03.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “SAM-ARS 2016” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-36164-01- 28-2025, me objekt: “Materiale elektrike”, me fond limit 3,749,738.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MURATI D” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “VASSA” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“MURATI D” SHPK, me NIPT (K42003004T), me adresë: “Rruga Kavajës”, Ish- Kombinati Ushqimor, Godinë 1-katëshe.

Operatori ekonomik “VASSA” SHPK, me Nipt K01421002H, Adresa: Lagjja: “Kryengritja e Fierit”, Fier.

“SAM-ARS 2016” SHPK, me NIPT (L62629204V), me adresë: Elbasan, Zona kadastrale N8526, Ndërtese nr. pasurisë 1327/27.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan, me adresë: Rruga “11 Nëntori”, Elbasan.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e lart monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomik ankimues “MURATI D” SHPK, “VASSA” SHPK dhe “SAM-ARS 2016” SHPK, kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.5. Ankimuesit kanë plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.01.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-36164-01- 28-2025, me objekt: “Materiale elektrike”, me fond limit 3,749,738.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan.

II.2. Në datën 17.02.2025, autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “MURATI D” sh.p.k.	2.376.550	Skualifikuar
2. “ERVIN LUZI” sh.p.k.	2.590.500	Skualifikuar
3. “VASAA” sh.p.k.	2.725.050	Skualifikuar
4. “ARTEO 2018” sh.p.k.	2.794.500	Skualifikuar
5. “2 AS INVEST” sh.p.k.	2.812.305	Skualifikuar
6. “HEST” sh.p.k.	2.813.850	Skualifikuar
7. “LUAR Bros” sh.p.k.	2.832.499	Skualifikuar
8. “ALMA KODRA” sh.p.k.	2.847.750	Skualifikuar
9. “ZEQIRI” sh.p.k.	2.892.750	Skualifikuar
10. “MURATI” sh.p.k.	2.958.900	Skualifikuar
11. “SAM-ARS 2016” sh.p.k.	2.994.700	Skualifikuar
12. “Qamil Doka” sh.p.k.	3.184.100	Kualifikuar
13. “Luan Spahija” sh.p.k.	3.207.500	Skualifikuar
14. “GENERAL TRADING” sh.p.k.	3.321.666	Skualifikuar

15. “DOKSANI-G” sh.p.k.	3.367.250 Skualifikuar
16. “EKM Konstruksion&Teknologji” sh.p.k.	3.388.850 Skualifikuar

II.3. Në datën 21.02.2025, autoriteti ka bërë publikimin e njoftimit të fituesit paraprak për procedurën e prokurimit publik në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.4. Në datën 24.02.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa online me nr. A/2025/5076, dhe me nr. protokoll 524/2025 datë 24.02.2025 e operatorit ekonomik “MURATI D” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-36164-01-28-2025, me objekt: “Materiale elektrike”, me fond limit 3,749,738.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan, ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës së paraqitura nga operatori ekonomik ankimues “MURATI D” SHPK.

II.4.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 524/1 prot., datë 25.02.2025 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “MURATI D” SHPK në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.4.3. Me shkresën nr. 70/13 prot., datë 03.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 524/2 prot., datë 05.03.2025 me objekt “Dërgohet vendimi i shqyrtimit të ankesës” është depozituar nga autoriteti kontraktor nëpërmjet SEA, vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “MURATI D” SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se e nuk e ka pranuar atë, me arsyetim si më poshtë:

“[...]

Në mënyrë të përmbledhur ankimuesi pretendon si më poshtë vijon:

1. Skualifikimi i ardhur nga KVO, pasi në artikullin Nr. 3 të preventivit ishte bërë gabim në sasi nga 350 copë në 345 copë e cila në përlllogaritje të vlerës është më e vogël se 2% dhe Ak duhet të kërkonte sqarim, pasi në këtë mënyrë është jashtë detyrimit ligjor të LPP.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi arsyetoj për sa më poshtë:

Operatori Ekonomik i cili oferton paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur të cilet duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim nga ai i përcaktuar nga AK.

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit zbatohen rregullat e LPP për sa i përket gabimeve Aritmetike.

Përsa më sipër oferta juaj ka patur ndryshime në sasinë e përcaktuar nga Ak te cilat kanë prekur përmbajtjen e saj duke ndryshuar thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër, pretendim i ankuesit për këtë nuk qëndron në zbatim të Nenit 92 “Shqyrtimi i ofertave” të LPP

2. Llamba e dorëzuar Led 40ë është brenda standardeve të kërkuara.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi arsyetojmë përsa më poshtë:

Në vijim të pretendimit tuaj, KSHA pranë AK bëri rivlerësimin e llambës dhe konstatoj se përmasat e saj nuk ishin në përputhje me përmasat e kërkuara njësor siç është pasqyruar në procesverbalin e Kvo të mbajtur dt. 10.02.2025.

Për sa më sipër, pretendim i ankuesit për këtë nuk qëndron

3. KVO nuk vlerësoj mostrat në momentin e dorëzimit pranë AK dhe pa pranin e operatorit të interesuar duke e vlerësuar këtë si diçka abuzive.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi arsyetoj për sa më poshtë:

Pika 2.3.3 e kriterëve për kualifikim “Për dorëzimin e mostrave” pranë Ak në momentin e hapjes së ofertave është pjese e procesit të vlerësimit i cili sipas Neni 55 Procedurë e hapur e thjeshtuar Pika 4 e VKM përcakton afatin e shqyrtimit të ofertave në 5 Ditë.

Përsa më sipër duke vlerësuar se KVO ka respektuar afatet ligjore të përcaktuara, pretendimi i mësipërm nuk qëndron.

Sqarojmë gjithashtu se në proces verbalin e mbajtur nga Kvo Dt. 10.02.2025 i cili i është komunikuar Operatorit me anë të App-së shënohet gjithashtu në arsyet e skualifikimit pika 2: fotoelementi (rele muzgu) sipas specifikimeve duhet të ishte 16 A ndërkohë elementi i dorëzuar në mostër është 12A.

Kjo arsye e skualifikimit nuk është kontestuar nga OE i cili në mënyre indirekte e ka pranuar si arsye skualifikimi.

Bazuar në sa është trajtuar me sipër si dhe bazuar në dokumentacionin provues, bashkëlidhur këtij vendimi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës

Vendosi

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori Ekonomik "Murati D" për procedurën Blerje Materiale Elektrike me fond limit 3 749 738 lekë pa t.v.sh.”

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5079, datë 24.02.2025 dhe me Nr. 528/2025 Prot., datë 24.02.2025 e operatorit ekonomik "VASSA" SHPK, për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar" Mallra, me Nr. REF-36164-01-28-2025, me objekt: "Blerje Materiale elektrike", Marrëveshje Kuadër, me fond limit 3,749,738 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.02.2025, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale, Bashkia Elbasan.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 528/1 prot., datë 25.02.2025 lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "VASSA" SHPK, nga procedura e prokurimit sipërcituar.

II.4.3. Me shkresën nr. 70/14 prot., datë 03.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 528/2 prot., datë 05.03.2025 me objekt "Dërgohet vendimi i shqyrtimit të ankesës" është depozituar nëpërmjet SEA, nga autoriteti kontraktor vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues "VASSA" SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se e nuk e ka pranuar atë, me arsyetim si më poshtë:

"[...]"

Në mënyrë të përmbledhur ankimuesi pretendon si më poshtë vijon:

- 1. Skualifikimi i KVO është i padrejtë, pasi llamba e dorëzuar është 4000 K e njëjtë me kërkesën e AK e cila kërkohet 4200 K, pasi sipas direktivave Evropiane shkalla e ndriçimit led e shprehur në Kelvin ndahet në kategori: 2200k, 2700K-3000k, 4000 K - 4500 K, 5000K - 6500 K. Llamba e dorëzuar nuk sjell asnjë ndryshim në ndriçim apo efikasitet.*

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi arsyetojmë për sa më poshtë: Sipas direktivave të cituar nga OE grupimi shkallës Kelvin bëhet sipas ndarjes së përcaktuar më lartë në bazë të së cilës elementi i kërkuar dhe ai i dorëzuar i përkasin grupimit 4000K- 4500K (Neutral ëhite) por nga ana jonë është kërkuar ndriçimi led 4200 K si shkalla e ngjyrës së ndriçimit led. Ky ndriçim është me afër një ngjyre "Cool Ëhite" dhe është më i ftohtë dhe më e ndritshme se drita 4000K e dorëzuar nga ju.

Ngjyra e ndriçimit 4200K është e përshtatshme për ambiente që kërkojnë më shumë ndriçim (ndriçim rrugor), ndërsa ngjyra e ndriçimit 4000K është e përshtatshme më mirë për zyra dhe ambiente të tjera të brendshme.

Shkalla e ngjyrës së ndriçimit led e kërkuar nga AK gjendet lehtësisht në treg pa qenë e nevojshme të sillen ngjyra të përafërta nga i njëjti grupim duke qenë kështu tregues që ky përcaktim nuk është diskriminues dhe me efekt parapërcaktimi.

Përsa me sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Bazuar në sa është trajtuar bashkëlidhur këtij vendimi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës:

Vendosi

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori Ekonomik "VASAA" për procedurën Blerje Materiale Elektrike me fond limit 3 749 738 lekë pa t.v.sh."

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5086, datë 26.02.2025 dhe me Nr. 562/2025 Prot., datë 26.02.2025 e operatorit ekonomik "SAM-ARS 2016" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur, e thjeshtuar", me Nr. REF-36164-01-28-2025, me objekt: "Materiale elektrike", me fond limit 3,749,738.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 562/1 prot., datë 27.02.2025 lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues "SAM-ARS 2016" SHPK., nga procedura e prokurimit sipërcituar.

II.4.3. Me shkresën nr. 70/15 prot., datë 07.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 562/2 prot., datë 11.03.2025 me objekt "Dërgim Vendimi" është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues "SAM ARS 2016" SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se e ka pranuar atë, me arsyetim si më poshtë:

"[...]"

Në mënyrë të përmbledhur ankimuesi pretendon si më poshtë vijon:

- 1. Të verifikohet kutia e mostrës së dorëzuar, pasi brenda saj është dhe fotoelementi de relea e muzgut.*

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi arsyetoj për sa më poshtë: KSHA bëri verifikimet përkatëse dhe rezultoi se në kutinë e dorëzuar për elementin Nr. 4 të mostrave ndodheshe: fotoelementi (sensori i lëvizjes), dhe 2 rele muzgu me fuqi A të ndryshme ndër të cilët 1 prej tyre i përmbushte specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

Për sa me sipër, pretendim i ankuesit qëndron.

2. Të verifikohen dhe mostrat e operatoreve të tjerë përsa i përket rreles se muzgut nëse janë sipas specifikimeve të kërkuara, pasi OE dyshon për lapsus në vlerësimin e fuqisë A dhe tek të tjerët.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi arsyetojmë përsa më poshtë:

Në vijim të pretendimit tuaj, KSHA pranë AK bëri rivlerësimin e të gjithë mostrave për OE pjesëmarrës. Duke zbatuar formulën e konvertimit të ËATTS në AMPER ($A = \frac{E}{V}$), KSHA bëri rivlerësimin si më poshtë:

1. DOKSANI-G me nipt L21809501H skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO
2. 2AS INVEST me nipt MI 1803504B skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO
3. ALMA KODRA me nipt K32725211G skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO
4. MURATI me nipt J66702413V skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.
5. ARTEO 2018 me nipt L82523203F skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.
6. EKM Konstruksion & Teknologji me Nipt M02403014N skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.
7. SAM ARS 2016 me nipt L62629204V KUALIFIKOHET.
8. ERVIN LUZI me nipt K717070070 skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.
9. GENERAL TRADING me nipt M21051011F skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.
10. HEST me nipt L21527009H skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.
11. Luan Spahija me nipt L01807503L skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.
12. LUAR BROS me nipt L72322004M skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.
13. MURATI D me nipt K42003004T skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.
14. VASSA me nipt J62903470T skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.
15. ZEQRIRI me nipt J67902827A KUALIFIKOHET
16. Qamil Doka me nipt L81924026A KUALIFIKOHET.

Për sa më sipër, pretendim i ankuesit qëndron.

Bazuar në sa është trajtuar më sipër si dhe bazuar në dokumentacionin provues, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës:

Vendosi

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori Ekonomik "SAM ARS 2016" për procedurën Blerje Materiale Elektrike me fond limit 3 749 738 (tre milion e shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa t.v.sh.

II.4.4. Me shkresën nr. 524/3 prot., datë 10.03.2025, është përcjellë tek autoriteti kontraktor kërkesa për informacion nga Komisioni i Prokurimit Publik, për dorëzimin e mostrave të paraqitura për këtë procedurë prokurimi nga operatorët ekonomikë "Murati D" SHPK, "VASSA" SHPK dhe "SAM-ARS 2016" SHPK së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre dhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre, në funksion të trajtimit të ankesës së operatorëve ekonomik të mësipërm.

II.4.5. Në datën 13.03.2025 është depozituar nga autoriteti kontraktor shkresa nr. 214/1 prot., protokolluar me tonën me nr. 524/4 prot, datë 13.03.2025, në të cilën konstatohet informacioni i kërkuar lidhur me dorëzimin e mostrave të paraqitura për këtë procedure prokurimi nga operatorët ekonomikë "Murati D" SHPK, "VASSA" SHPK, "SAM-ARS 2016" SHPK dhe "Qamil Doka" P.F së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre dhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre, në funksion të trajtimit të ankesës së operatorëve ekonomikë të mësipërm.

II.4.6. Referuar parashikimeve të nenit 113 të "Ligjit për prokurimin publik", i ndryshuar, rezulton se nuk ka argumente nga palët e interesuara, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cënohen nga ankesa e paraqitur, që kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "SAM-ARS 2016" SHPK duke kundërshtuar Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të sipërcituar, me argumentin se: "Skualifikohet pasi mostrat e dorëzuara nuk ishin sipas specifikimeve të prokuruar", dhe verifikimin e mostrave të operatoreve të tjerë përsa i përket rreles së muzgut nëse janë sipas

specifikimeve të kërkuara, pasi dyshohet për lapsus në vlerësimin e fuqisë A dhe tek të tjerët, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.2. Me shkresën nr. 70/15 prot., datë 07.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 562/2 prot., datë 11.03.2025 me objekt “Dërgim Vendimi” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues “SAM ARS 2016” SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se e ka pranuar atë, me arsyetim si më poshtë:

“[...]

Në mënyrë të përmbledhur ankimuesi pretendon si më poshtë vijon:

1. Të verifikohet kutia e mostrës së dorëzuar, pasi brenda saj është dhe fotoelementi de relea e muzgut.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi arsyetoj për sa më poshtë: KSHA bëri verifikimet përkatëse dhe rezultoi se në kutinë e dorëzuar për elementin Nr. 4 të mostrave ndodheshe: fotoelementi (sensori i lëvizjes), dhe 2 rele muzgu me fuqi A të ndryshme ndër të cilët 1 prej tyre i përmbushte specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

Për sa më sipër, pretendim i ankuesit qëndron.

2. Të verifikohen dhe mostrat e operatoreve të tjerë për sa i përket rreles së muzgut nëse janë sipas specifikimeve të kërkuara, pasi OE dyshon për lapsus në vlerësimin e fuqisë A dhe tek të tjerët.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi arsyetojmë për sa më poshtë:

Në vijim të pretendimit tuaj, KSHA pranë AK bëri rivlerësimin e të gjithë mostrave për OE pjesëmarrës. Duke zbatuar formulën e konvertimit të ĒATTS ne AMPER ($A = \frac{\ddot{E}}{V}$), KSHA bëri rivlerësimin si më poshtë:

1. DOKSANI-G me nipt L21809501H skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO
2. 2AS INVEST me nipt MI 1803504B skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO
3. ALMA KODRA me nipt K32725211G skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO
4. MURATI me nipt J66702413V skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.
5. ARTEO 2018 me nipt L82523203F skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.

6. EKM Konstruksion & Teknologji me Nipt M02403014N skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.

7. SAM ARS 2016 me nipt L62629204V KUALIFIKOHET.

8. ERVIN LUZI me nipt K717070070 skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.

9. GENERAL TRADING me nipt M21051011F skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.

10. HEST me nipt L21527009H skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.

11. Luan Spahija me nipt L01807503L skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.

12. LUAR BROS me nipt L72322004M skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.

13. MURATI D me nipt K42003004T skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.

14. VASSA me nipt J62903470T skualifikohet sipas proces verbalit Dt. 10.02.2025 të mbajtur nga KVO.

15. ZEQRIRI me nipt J67902827A KUALIFIKOHET

16. Qamil Doka me nipt L81924026A KUALIFIKOHET.

Për sa më sipër, pretendim i ankuesit qëndron.

Bazuar në sa është trajtuar më sipër si dhe bazuar në dokumentacionin provues, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës:

Vendosi

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori Ekonomik "SAM ARS 2016" për procedurën Blerje Materiale Elektrike me fond limit 3 749 738 (tre milion e shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa t.v.sh.**

III.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.4. Neni 115, pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *“1.Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin: i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar; ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

“2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me ankesën e pranuar nga autoriteti kontraktor, të operatorit ekonomik “SAM-ARS 2016” SHPK, për procedurën e prokurimit, objekt – ankimi.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “MURATI D” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: *“Dorëzimi i mostrave nuk ishte sipas specifikimeve teknike.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 7 *“Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”*, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“Shtojca 7

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia
1	Llamba 150 Ë E - 40	Copë	20
2	Llamba 250 Ë hps sodium	Copë	20

3	Llamba Led 40 ë me reduktor	Copë	345
---	-----------------------------	------	-----

[...]

PREVENTIVI

Nr	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Llamba 150 Ë E - 40	Copë	20		
2	Llamba 250 Ë hps sodium	Copë	20		
3	Llamba Led 40 ë me reduktor	Copë	345		

III.1.2. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8 “Formular i i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:”

“Shtojca 8

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

[...]

2.3.3. Operatores Ekonomik pjesëmarrës në këtë procedure prokurimi, duhet të paraqesin mostrat për elementet e mëposhtme sipas preventivit dhe specifikimeve të kërkuara në datën dhe orën e hapjes se tenderit në ambientet e Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale, adresa: Lagja Shkumbini Elbasan, konkretisht:

Nr.	EMËRTIMI
1	Llamba Led 40 ë me reduktor
2	Llamba 250 Ë hps sodium
3	Llamba led 15 Ë E-27
4	Fotoelemente (Rele Muzgu)
5	Drajver led 50 ë
6	Konektore abonenti trefazore
7	Automate 63 A 1 Polar
8	Automate 63 A 3 Polar
9	Percjelles i Veshur 6 mm
10	Percjelles i Veshur 10 mm

Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim”

III.1.3. Në dokumentet e tenderit, janë publikuar dhe “Specifikime teknike materiale elektrike”, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, ku autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:”

“SPECIFIKIME TEKNIKE MATERIALE ELEKTRIKE

[...]

Llampa led 40ë me reduktor

- *Jetëgjatësia: 35000 HRS*
- *Fuqia: 40 W*
- *Lloji: Panel LED*
- *Shkalla e mbrojtjes ndërkombëtare: IP20*
Përmasat: 90x212 mm
- *Lloji i llambës: SMD LED*
Reduktori për lidhje direkte në ndriçues
- *Lloji i ndriçimit: Neutral 4200 K*
- *Materiali: Alumini / PMMA*

e përshtatshme për zëvendësimin e llambave tradicionale të përziera me merkur HID që punojnë në 230V.

Kapak i përshtatësitor aksesor E27 në E40 në kuti

Kushtet elektrike të funksionimit

220 - 240V 50/60Hz

Temperatura e rekomanduar e ambientit

Pozicionimi: vertikal $\pm 45^\circ$

Koha e fillimit < 0,4 s

Numri i cikleve të ndërrimit përpara dështimit > 15.000

Koha e ngrohjes (deri në 95% të prodhimit të ndriçimit në gjendje të qëndrueshme) < 2.0 s”

III.1.4. Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket specifikimeve të mostrave, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik “MURATI D” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur mostrën me nr.rendor 3 si më poshtë:

1. Për produktin nr. rendor 1. “Llamba Led 40 W me reduktor”, mostra e paraqitur është në përmasat 100x190 mm dhe përmasat të kërkuar nga AK janë 90x212 mm. Nga verifikimi i mostrave rezulton se operatori ekonomik e nuk e ka të përcaktuar përmasën sipas kërkesës nga specifikimet teknike të AK.

III.1.5 Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk

përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

- a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;
- b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;
- c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;
- ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."

III.1.6 Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet “Specifikime teknike” janë: “b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

III.1.8. Në këtë rast, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit ka skualifikuar operatorin ekonomik “Murati D” Shpk, përkatësisht për mospërbushje të specifikimeve teknike lidhur artikullit nr.1 “Lampa led 40 ë me reduktor”. Referuar rastit konkret KPP vëren, se bazuar në përgjigjen e autoritetit kontraktor ky i fundit ka arritur të argumentojë teknikisht dhe në mënyrë shteruese se autoriteti kontraktor ka skualifikuar operatorin ekonomik për përmasat e artikullit nr.1 “Lampa led 40 ë me reduktor” të cilat janë 100x190 mm dhe jo sipas përmasave të kërkuar nga AK që janë 90x212 mm si organi përgjegjës për i hartimit të këtyre specifikimeve. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor si organ përgjegjës i mirëmenaxhimit të fondeve publike i cili është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjitha hapave të procedurës së prokurimit, duke përfshirë edhe hartimin e këtyre specifikimeve teknike në të cilin në rastin konkret ka argumentuar hartimin e specifikimeve teknike të cilat nuk duhet të jenë diskriminuese si dhe në përputhje me qëllimin e ligjit për prokurimin publik për nxitjen e transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “MURATI D” Shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “MURATI D” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: *“Preventimi i formularit të ofertës është sjellë në mënyrë të gabuar, pasi ndryshon sasia e zërit nr.3”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në dokumentet e procedurës së mësipërme të prokurimit të publikuara në SPE, rezulton se në Seksionin I - Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, përcaktohet:

**1. Formularët e
Ofertës dhe Listat
Çmimeve**

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shogërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personi (at) e Autorizuar.

**2. Ofertat
Alternative**

Përveç nëse përshkruhet ndryshe në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit propozimet alternative ose kohët alternative për përfundimin, nuk do të merren parasysh.

3. Çmimet

1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës Ekonomike do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuar në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit.
2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të dorëzohen, sasi të dhe çmimin e tyre.
3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Mallrat pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.
5. Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara; ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër”

10.Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave

Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, çdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

22. Korrigjimi i gabimeve arithmetike dhe i ofertës anomalisht të ulët

1. Autoriteti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime arithmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime arithmetike, autoriteti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime arithmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

III.2.2. Në shtojcën 1 “FORMULARI I OFERTËS” të dokumenteve të tenderit, është kërkuar:

Shtojca 1.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE¹

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: [Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

¹ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne [vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti), nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
---	--

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

III.2.3. Ndërsa në Shtojcën 2 “Lista e Çmimeve të artikujve”, të dokumenteve të tenderit për procedurën objekt - shqyrtimi përcaktohet:

Shtojca 3.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe të grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe t’u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					

2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Data _____					

III.2.4. Në Shtojcën 7 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të lëvrimit”, të dokumenteve të tenderit për procedurën objekt - shqyrtimi përcaktohet:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia
1	Llampa 150 Ë E - 40	Copë	20
2	Llampa 250 Ë hps sodium	Copë	20
3	Llampa Led 40 ë me reduktor	Copë	345
4	Ndezëz	Copë	80
5	Driver led 50 ë	Copë	70
6	Pllaketa Led 50 ë	Copë	100
7	Llampa led 15 Ë E-27	Copë	200
8	Rele kohe (Timer)	Copë	15
9	Konektorë abonenti trefazorë	Copë	100
10	Fotoelemente (Rele Muzgu)	Copë	180

11	Lëshues 125 A	Copë	18
12	Lëshues 150 A	Copë	13
13	Nastroizolant	Copë	300
14	Klema $\varnothing$ 4 dhe 10	Copë	200
15	Bullona + Dado + Upa $\varnothing$ 8	Copë	200
16	Bullona + Dado + Upa $\varnothing$ 10	Copë	100
17	Kapak Metalik Shtyllë Xingato Zippo	Copë	70
18	Kapak plastik për puseta plastike 30x30cm	Copë	40
19	Kapak plastik për puseta plastike 40x40cm	Copë	30
20	Morseta + Kapuç $\varnothing$ 25 dhe $\varnothing$ 16	Copë	100
21	Tirant ABC + Fasheta Shtyllë	Copë	50
22	Portollampa Porcelani E - 27	Copë	150
23	Automate 10 A 1 Polar	Copë	50
24	Automate 16 A 1 Polar	Copë	50
25	Automate 25 A 1 Polar	Copë	100
26	Automate 32 A 1 Polar	Copë	100
27	Automate 40 A 1 Polar	Copë	100
28	Automate 63 A 1 Polar	Copë	50
29	Automate 32 A 3 Polar	Copë	50
30	Automate 40 A 3 Polar	Copë	50
31	Automate 63 A 3 Polar	Copë	10
32	Automate 100 A 3 Polar	Copë	10
33	Përcjellës i Veshur 2.5 mm	ml	1900
34	Përcjellës i Veshur 1.5 mm	ml	200
35	Përcjellës i Veshur 6 mm	ml	400
36	Përcjellës i Veshur 10 mm	ml	390
37	Dare matëse tensioni digjital	Copë	1
38	Multimeter digjital	Copë	1

PREVENTIVI

Nr	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Llampa 150 Ë E - 40	Copë	20		
2	Llampa 250 Ë hps sodium	Copë	20		
3	Llampa Led 40 ë me reduktor	Copë	345		
4	Ndezëz	Copë	80		
5	Driver led 50ë	Copë	70		
6	Pllaketa Led 50ë	Copë	100		
7	Llampa led 15 Ë E-27	Copë	200		
8	Rele kohe (Timer)	Copë	15		
9	Konektorë abonenti trefazorë	Copë	100		
10	Fotoelemente (Rele Muzgu)	Copë	180		
11	Lëshues 125 A	Copë	18		

12	Lëshues 150 A	Copë	13		
13	Nastroizolant	Copë	300		
14	Klema ϕ 4 dhe 10	Copë	200		
15	Bullona + Dado + Upa ϕ 8	Copë	200		
16	Bullona + Dado + Upa ϕ 10	Copë	100		
17	Kapak Metalik Shtyllë Xingato Zippo	Copë	70		
18	Kapak plastik për puseta plastike 30x30cm	Copë	40		
19	Kapak plastik për puseta plastike 40x40cm	Copë	30		
20	Morseta + Kapuç ϕ 25 dhe ϕ 16	Copë	100		
21	Tirant ABC + Fasheta Shtyllë	Copë	50		
22	Portollamba Porcelani E - 27	Copë	150		
23	Automate 10 A 1 Polar	Copë	50		
24	Automate 16 A 1 Polar	Copë	50		
25	Automate 25 A 1 Polar	Copë	100		
26	Automate 32 A 1 Polar	Copë	100		
27	Automate 40 A 1 Polar	Copë	100		
28	Automate 63 A 1 Polar	Copë	50		
29	Automate 32 A 3 Polar	Copë	50		
30	Automate 40 A 3 Polar	Copë	50		
31	Automate 63 A 3 Polar	Copë	10		
32	Automate 100 A 3 Polar	Copë	10		
33	Përcjellës i Veshur 2.5 mm	ml	1900		
34	Përcjellës i Veshur 1.5 mm	ml	200		
35	Përcjellës i Veshur 6 mm	ml	400		
36	Përcjellës i Veshur 10 mm	ml	390		
37	Dare matese tensioni digjital	Copë	1		
38	Multimetër digjital	Copë	1		
	Shuma				3.749.738
	Tvsh 20%				
	Totali				

Afati i lëvrimet 12 Muaj

III.2.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në përmbushje të kriterit sa më sipër, operatori ekonomik “Murati D” SHPK, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojcën 1 “Formularin e Ofertës”.

- Shtojcën 2 “Lista e çmimeve të shërbimeve” si më poshtë:

Artikulli	Përshkrimi i mallit	njësia	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total
					Çmimi total
1	Llampa 150 W E - 40	Copë	20	1500	30000
2	Llampa 250 W hps sodium	Copë	20	1500	30000
3	Llampa Led 40 w me reduktor	Copë	350	950	332500
4	Ndezëz	Copë	80	700	56000
5	Driver led 50w	Copë	70	800	56000

III.2.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.7. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, në Seksionin 1 pjesa “Udhëzime për operatorët ekonomikë” në pikat 4 dhe 6, përcaktohet se: “Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”, “Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar shërbimet që do të kryhen dhe çmimin e tyre”. Gjithashtu, në këto dokumente në Shtojcën 3 “Lista e çmimeve të artikujve” (Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik), është përcaktuar “Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe t’u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në

refuzimin e ofertës ”

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve dhe kushteve për përzgjedhjen e fituesit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vlerësimit dhe krahasimit të ofertave. Referuar sa më sipër, nisur nga arsyeja e skualifikimit se *“Preventimi i formularit te ofertes është sjellë në mënyrë të gabuar pasi ndryshon sasia e zërit nr.3”*, KPP nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Murati D” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka dorëzuar të plotësuar Shtojcën 2 “Lista e Çmimeve të Artikujve”, ku ka përcaktuar: 3.Llamba Led 40 ë me reduktor, Copë, **Sasia 350**, Çmimi për njësi 950, Çmimi total 332500. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në seksionin Udhëzime të dokumenteve të tenderit, citohet se *“...Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.”*, ku në rastin konkret, konstatohet, se operatori ekonomikë ankimues nuk ka plotësuar saktë shtojcën 2, pasi në të nuk janë pasqyruar të gjitha zërat e artikujve siç janë kërkuar nga autoriteti kontraktor. Konkretisht në shtojcën 2 përcaktohet qartë mënyra e plotësimit të saj nga operatorët ekonomikë, *“Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe t’u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.”*, me qëllim evidentimin e të gjithë zërave të artikujve të kërkuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomikë ankimues “Murati D” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK duke kundërshtuar Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të sipërcituar, me argumentin se: *“Dorëzimi i mostrave nuk ishte sipas specifikimeve teknike.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.2. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8 “Formular i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:”

“Shtojca 8

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

[...]

2.3.3. Operatoret Ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, duhet të paraqesin mostrat për elementët e mëposhtëm sipas preventivit dhe specifikimeve të kërkuara në datën dhe orën e

hapjes së tenderit në ambjentet e Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale, adresa: Lagjja “Shkumbini”, Elbasan, konkretisht:

Nr.	EMËRTIMI
1	<i>Llampa Led 40 ë me reduktor</i>
2	<i>Llampa 250 Ë hps sodium</i>
3	<i>Llampa led 15 Ë E-27</i>
4	<i>Fotoelemente (Rele Muzgu)</i>
5	<i>Drajver led 50 ë</i>
6	<i>Konektore abonenti trefazore</i>
7	<i>Automate 63 A 1 Polar</i>
8	<i>Automate 63 A 3 Polar</i>
9	<i>Përcjellës i Veshur 6 mm</i>
10	<i>Përcjellës i Veshur 10 mm</i>

Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.

III.2.3. Në dokumentet e tenderit, janë publikuar dhe “Specifikime teknike materiale elektrike”, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, ku autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:”

SPECIFIKIME TEKNIKE MATERIALE ELEKTRIKE

[...]

3. Llamba led 40ë me reduktor

- *Jetëgjatësia: 35000 HRS*
- *Fuqia: 40 Ë*
- *Lloji: Panel LED*
- *Shkalla e mbrojtjes ndërkombëtare: IP20*
Përmasat: 90x212 mm
- *Lloji i llampës: SMD LED*
Reduktori per lidhje direkte ne ndricues
- *Lloji i ndriçimit: Neutral 4200 K*
- *Materiali: Alumini / PMMA*

e përshtatshme për zëvendësimin e llambave tradicionale të përziera me merkur HID që punojnë në 230V.

Kapak i përshtatësit aksesori E27 në E40 në kuti

Kushtet elektrike të funksionimit

220 - 240V 50/60Hz

Temperatura e rekomanduar e ambientit

Pozicionimi: vertikal $\pm 45^\circ$

Koha e fillimit $< 0,4$ s

Numri i cikleve të ndërrimit përpara dështimit > 15.000

Koha e ngrohjes (deri në 95% të prodhimit të ndriçimit në gjendje të qëndrueshme) < 2.0 s”

III.2.4. Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket specifikimeve të mostrave, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe mostrave të paraqitur nga operatori ekonomik “VASSA” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur mostrën me nr.rendor 3 si më poshtë:

1. Për produktin nr. rendor 1. “Llamba Led 40 ë me reduktor”, mostra e paraqitur nuk i ka specifikimet sipas modelit të kërkuar nga AK. Nga verifikimi i mostrave rezulton se operatori ekonomik e ka të përcaktuar ndriçimin led 4000 K si shkallë e ngjyrës së ndriçimit led përmbajte kjo jo sipas kërkesës nga specifikimet teknike të AK e cila kërkohej me 4200 K.

III.2.5 Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma*

funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.2.6 Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet “Specifikime teknike” janë: “b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

III.2.7. Në këtë rast, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor sipas specifikimit për të cilin ka skualifikuar operatorin ekonomik “VASAA” Shpk, përkatësisht për ndriçimin led 4000 K si shkallë e ngjyrës së ndriçimit, përpos faktit që i takojnë karakteristikave minimale teknike të një ndriçimi që është më i ftohtë i takon as dhe funksionalitetit të ndriçimit për mallrat të cilat do të prokurohen. Referuar rastit konkret KPP vëren, se bazuar në përgjigjen e autoritetit kontraktor ky i fundit ka arritur të argumentojë teknikisht dhe në mënyrë shteruese pse autoriteti kontraktor ka

kërkuar një specifikim të tillë dhe përse mund t'i shërbejë ky specifikim, për shkallën e ngjyrës së ndriçimit 4200 K nga 4000 K e ofruar nga operatori ekonomik ankimues. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor si organ përgjegjës i mirëmenaxhimit të fondeve publike i cili është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjitha hapave të procedurës së prokurimit, duke përfshirë edhe hartimin e këtyre specifikimeve teknike të cilin nuk duhet të jenë diskriminuese si dhe në përputhje me qëllimin e ligjit për prokurimin publik për nxitjen e transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, prandaj KPP e gjykon të drejtë kërkesën e autoritetit kontraktor.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar nga autoriteti kontraktor të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “SAM-ARS 2016” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-36164-01- 28-2025, me objekt: “Materiale elektrike”, me fond limit 3,749,738.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Murati D” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-36164-01- 28-2025, me objekt: “Materiale elektrike”, me fond limit 3,749,738.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan.
3. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK, për procedurën e prokurimit, objekt – ankimi.

4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi dhe vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomikë “SAM-ARS 2016” Shpk.
 6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kalimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “VASSA” Shpk dhe “Murati D” Shpk, në buxhetin e shtetit.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Gjergj Mersini

Kryetar

Jonaid Myzyri

